



Raporti i Progresit i Muajit Maj 2017

Programi SCPA ka zhvilluar përgjatë muajit Maj 2017 këto aktivitete kryesore: realizimi i takimit të dytë të Grupit të Përbashkët të Punës në nivel qendror; realizimi i takimit të parë të Grupit të Përbashkët të Punës në nivel lokal (DVP Kukës); takimi i tretë i Grupit Teknik të fazës së ngjizjes për të diskutuar për kuadrin rregullator, përmirësimet në infrastrukturë dhe përditësimi i matricës së riskut; përfundimi i punës për hartimin e strukturës së Planit të Rritjes së Kapaciteteve, pjesë e Raportit të Ngjizjes; takime të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të PSH-së.

Më poshtë një përshkrim i shkurtër i aktiviteteve kryesore:

- Sipas Planit të Punës së fazës së ngjizjes, me 9 maj 2017 u mbajt takimi i dytë i Grupit të Përbashkët të Punës (GPP) në nivel qendror. Takimi u bashkëkryesua nga Drejtori i Departamentit për Sigurinë Publike, Z. A. Qato, Z. Pontus Forberg, Drejtori i Programit. Mori pjesë gjithashtu një përfaqësuese e MPB-së. Diskutimet në GPP u përqendruan kryesisht te propozimet e bëra nga grupi teknik në lidhje me ndërhyrjet në DVP-të pilot; prezantimi i gjetjeve dhe konkluzioneve nga studimi bazë i bërë për DVP Kukës dhe Elbasan; diskutime për të ngritur një grup pune për të kryer “Studimin për Menaxhimin Strategjik për dy DVP-të pilot dhe nevojat për përmirësime të mëtejshme”. GPP mori dy vendime:
 - Hartimi i një raporti për Z. Haki Çako, Drejtor i Përgjithshëm, për propozimin e pilotimin të një modeli të ri komisarati policie.
 - Bashkëkryesuesit e GPP-së do të vendosin mbi përbërjen dhe detajet e tjera të grupit të punës që do të kryejë “Studimin për Menaxhimin Strategjik për dy DVP-të pilot dhe nevojat për përmirësime të mëtejshme”.
- Në kuadrin e ngritjes së GPP në nivel DVP-je pilot, EMP organizoi me 24 maj 2017 takimin e parë në Kukës. Një këtë takim morën pjesë përfaqësues të sektorëve kyç të DVP-së dhe tre komisarateve. Në këtë takim u morën tri vendime:
 - Komisarati i Kukësit u përzgjedh për pilotimin e modelit të miratuar, por ndërkohë një sërë aktiviteteve do kryhen paralelisht edhe në komisaritet e Hasit dhe Tropojës.
 - U caktua ndërlidhësi/koordinatori mes EMP-së dhe DVP Kukës.
 - Detajimi i Planit të Përbashkët të Punës do të fillojë në Shtator të 2017.
- Me 26 Maj, EMP organizoi takimin e tretë me Grupin Teknik për fazën e ngjizjes, për të diskutuar në lidhje me përmirësimet e menjëhershme dhe afatgjata tek rregulloret (procedurat standarte, strukturat etj); mundësitë për përmirësime në infrastrukturë (komisariate, zyra intervistimi, zyrat e pritjes së qytetarëve, ambientet e shoqërimit etj); përditësimi i Matricës së Riskut.
- Përgjatë muajit maj, EMP ka qënë tërësisht e përfshirë në hartimin e Planit të Rritjes së Kapaciteteve. Puna e kryer deri më tani është bërë brenda afateve kohore të parashikuara. Ndërkohë, një sërë takimesh janë kryer me përfaqësues të PSH-së për të tema që kanë të bëjnë me asistencën e programit.
- EMP gjithashtu bën me dije se, me dakordësinë e Donatorit, mbledhja e parë e Komitetit Drejtues të Programit do të mbahet në Shtator. Faza e zbatimit të Programit fillon po në këtë muaj.